



Prishtinë: 19.05.2016

Kodi i ZRRE-së: V_816_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1446_02_16**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **15.03.2016**.

në seancën e mbajtur më datë 19 maj 2016, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit M. M. me shifër DPR - 5410 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1446_02_16** i datës 05.02.2016.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 15.03.2016 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori M. M. (parashtruesi Uran Mehmeti) i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE për këto shkaqe: 1. Nuk i ka ndihmuar ankesës sime;; 2. Kundërshtimi tjetër ka të bëjë leximin paushall pasi sipas konsumatori punëtorët e KEDS-it kanë qasje te pika matëse.

Nga shkresat e lëndës vërehet se Departamenti i faturimit në KESCO me datë 21.03.2015 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën mars 2015 me shpenzim prej **3,683** datë 21.03.2015 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar faturimin për periudhën mars 2015 për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë dhe faturimit paushall.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se me datë 28.03.2015 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 47553683, ku TL=017722 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=007248 kWh (tarifa e ulët).

Pas ankesës së konsumatorit Departamenti për Konsumator në KEDS i është përgjigjur konsumatorit duke e **aprovuar pjesërisht** ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike, si dhe procesverbalit të inspektimit nr. 0156993 të datës 28.03.2015 duke bërë korrigjimin e faturave për periudhën 08/2014 deri në periudhën 03/2015 në vlerë **-71.38€**.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 19.05.2015 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga ana e konsumatorit M. M. dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të shkresave të lëndës dhe vendimit të DMK-së ka vërejtur se organi i shkallës së parë ka bërë gjithë analizat e nevojshme të rrjedhës së energjisë së shpenzuar nga konsumatori për pjesën e faturimit pa matje/paushall. Analiza e bërë nga DMK ka përfshirë analizën e përgjithshme të shpenzimit të energjisë elektrike, ku gjatë kësaj analize është konstatuar se konsumatori me shifër DPR – 5410 nga periudha prill 2014 e deri më mars 2015 nuk ka lexim dhe faturim të rregullt, pra ka lexim dhe faturim pa matje / paushall. Po ashtu sa i përket mos faturimit me të rregullt të pikës matëse, Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe e leximit për periudhën maj 2014 deri në prill 2015 dhe se edhe nga listat e leximit ka konstatuar se konsumatori nuk ka lexim dhe faturim të shpenzimeve të rregullta për periudhat 05/06/08/09/10/11/12/2014 dhe 01/02/2015 përkatësisht për këto periudha lexuesi i KEDS-it ka evidentuar që konsumatori faturohet me vlerësim/pa matje.

Bordi i ZRRE-së gjatë shqyrtimit të lëndës ka shqyrtuar korrigjimin e bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe gjatë shqyrtimit konstaton se KESCO ka vepruar drejt kur ka bërë shpërndarjen e shpenzimit të energjisë elektrike (kilovatorë – kWh), si dhe korrigjimin e faturave për periudhën 08/2014-03/2015 pasi siç u theksua më lartë konsumatori gjatë kësaj periudhe ka faturim pa matje/paushall, dhe se i tillë shpërndarja e shpenzimit të energjisë elektrike është në përputhje me nenin 23, paragrafi 3 i Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji.

Sai përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se vendimi DMK nuk i ka ndihmuar ankesës së konsumatorit, Bordi i ZRRE ka analizuar në detaje shkresat e lëndës dhe vendimin e organit të shkallës së parë ku ka vërtetuar se DMK përveç faturave të analizuar e të korrigjuara nga ndërmarrja e energjisë ka analizuar edhe faturat e konsumatorit për periudhën 05 dhe 06 të vitit 2014, dhe ka konstatuar se konsumatori për këto dy periudha nuk është faturuar me shpenzime reale mujore, ku në muajin 05/2014 është faturuar pa matje, ndërsa në muajin 06/2014 është faturuar pa shpenzim, andaj edhe ka kërkuar që të bëhet shpërndarja e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 05/2014 – 07/2014 dhe se gjatë llogaritjes ka rezultuar që korrigjimi i cili duhet t'i bëhet konsumatorit është në vlerë **-3.43€**.

Bordi ka konstatuar se organi i shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike në menyrë të drejtë dhe të plotë, pasi që janë analizuar në detaje rrjedhat e energjisë elektrike për këtë pikë matëse dhe janë vërtetuar saktësisht të dhënat e kilovatorëve të marra në njehsorin elektrik përmes procesverbalit të inspektimit.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 19.05.2016 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Krenar Bujupi, anëtar

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit M. M.
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.